



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1712/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Saranda Bogaj Sheremeti kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Afroni” ShPK me seli në Prizren, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1531/19, të datës 05.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit “Afroni” ShPK me seli në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1531/19, të datës 05.10.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1531/19, të datës 05.10.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e

paditësit “Afioni” ShPK me seli në Prizren. Ndërsa mbetet në fuqi vendimi nr.152/2019 i datës 27.05.2019, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e autorizuar i paditësit, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi i atakuar A.nr.1531/19, të datës 05.10.2021 të priset dhe çështja ti kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit “Afioni” ShPK me seli në Prizren të aprovohet në tërësi si e bazuar duke anuluar vendimin nr.152/2019 i datës 27.05.2019 i lëshuar nga e paditura Administrata Tatimore e Kosovës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.152/2019 i datës 27.05.2019, nën pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesa nr.152/2019 të datës 29.03.2019 e subjektit “Afioni” ShPK me numër të regjistrimit të biznesit (NRB) 71160157, si dhe numër fiskal (NRF) 601255385 me drejtor z.F.Xh., me seli të biznesit rr. “Ilaz Kuka” 21 Prizren në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, në lidhje me nenin 89 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, është vendosur Njoftimi i Vlerësimit për Rimbursim/kthim të mjeteve-Transferi në obligimet e subjektit NPQ “Afioni” Shpk në vlerë prej 30,340.15€ me nr. AU02700000009290 të datës 01.03.2019 të vërtetohet si i bazuar.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 27.06.2019 me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.152/2019 i datës 27.05.2019, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstatoi se e paditura pas kërkesës së paditësit për rimbursim të TVSH-së ka analizuar gjithë dokumentacionin dhe ka vërtetuar se ka mos përputhje në mes të deklaratave dhe librave, ndërsa sipas kërkesës së dytë për rimbursim është konstatuar se pronari i biznesit “Afioni” ShPK z. F.Xh. dhe bashkëpronarët e subjektit NPQ “Afioni” z. Z.Xh. dhe z. N.Xh. janë persona të lidhur. Paditësit në këtë rast me Njoftim Vlerësimin për rimbursim/kthim të mjeteve të datës 01.03.2019 i është aprovuar vlera e rimbursimit në vlerë prej 30,340.15€ e cila i është transferuar në obligimet e subjektit NPQ “Afioni” ShPK, pasi që është vërtetuar se janë persona të lidhur ndërsa shuma tjetër në vlerë prej 8,659.85€ kanë qenë obligime ndaj ATK-së. Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese gjendja faktike në këto raste dhe një gjendje e tillë nuk kontestohet nga paditësi as në padi e as në seancën e shqyrtimit kryesor, dy pronarët e dy subjekteve janë vëllezër andaj si e tillë e paditura ka trajtuar si persona të lidhur në kuptim të nenit 1.27 të Ligjit nr.03/L-222 i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin nr.04/L-102 dhe 04/L-223 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykata nuk ka mundur ti merr për bazë pretendimet e paditësit se paditësi nuk ka asnjë transaksion financiar që vërteton se të dy bizneset janë persona të lidhur dhe që kanë marrëdhënie të veçanta, përveç se janë familjar, pasi që nga dëshmitë të siguruar nga e paditura është vërtetuar se në llogarinë bankare të subjektit “Afioni” ShPK dhe NPQ “Afioni” Shpk janë autorizuar personat N.Xh. (vëllai), F.Xh. (paditësi)dhe Z.Xh. (babai). Kontrata e lidhur në mes të “Afioni” ShPK, (kontraktor) dhe “KEDS” Sha, për punimet që do të kryhen janë nënshkruar nga N.XH. i cili është nënshkruar në cilësinë e pronarit të subjektit ekonomik “Afioni” ShPK dhe fare nuk figuron F.Xh.. Në listën e punëtorëve të subjektit ekonomik “Afioni” ShPK në këtë rast paditësi është përfshirë N.XH.. Andaj paditësit i janë ndaluar obligimet tatimore nga ATK për arsye se pronarët e të nejjtit nuk mund të kërkojnë rimbursim/kthim të mjeteve tepriçë ndërsa subjekti tjetër ekonomik mos të

bëjë pagesën e obligimeve tatimore ku vlera e këtyre obligimeve është më e madhe. Nga kjo gjendje faktike gjykata konstaton se organi i paditur ATK ka vepruar drejtë kur ka transferuar mjetet në obligimet e subjektit NPQ “Afioni” Shpk duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 1 të paragrafit 1.27 të Ligjit 03/L-222 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102 dhe 04/L-223 për Administratën Tatimore dhe Procedurat për personat e lidhur. Pas analizës dhe vlerësimit të gjendjes faktike gjykata erdhi në përfundim se e paditura me vendimin kontestues në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e legjislacionit tatimor dhe dispozitat e procedurës administrative. Janë të pa bazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet ngase vendimi i goditur është i qartë i kuptueshëm. Arsyetimi i vendimit të goditur përmban arsyet të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe po ashtu kjo gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë i së drejtës materiale në këtë çështja administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. . Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81.G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se me asnjë provë nuk vërtetuar se subjekti “Afioni” Shpk, këtu paditësi ka për obligim që të mbuloj obligimet e një subjekti tjetër, pasi që edhe nga administrimi i provave përkatësisht nga raporti i kontrollit i datës 30.11.2018 në faqen 4 të këtij raporti është theksuar se “është verifikuar lista e bizneseve delikuede dhe nuk kemi hasur në ndonjë transaksion për këto biznese”. E cila provë vërteton faktin se paditësi nuk ka lidhje me asnjë biznes e as transaksion në mes tyre. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara

për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Ngase Dhoma e Shkallës së Dytë ka konsideruar se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim kolegji ka vlerësuar se paditësi nuk ka arritur të mbështesë me prova pretendimet e tij në ankesë, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 81.F par.1 të Ligjit Nr.04/L-102, pasi që në bazë të kësaj dispozite përcaktohet se *“1. Tatimpaguesi do të bartë detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj”*. Ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 7 par.1 dhe 3 të LPK-së, është përcaktuar se *“7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. 7.3 *Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”*. Prandaj, nga kjo gjendje gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ka mundur që të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se pretendimet e fakteve në këtë rast bien në barrë të paditësit i cili në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin të kundërtën e konstatimeve nga vendimi kontestues. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA-së, dhe Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, ngase vlerëson se të njëjtat janë pa bazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Sepse, sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

K.DH.SH.II.nr.1712/22, me datë 19.04.2024

**Kryetare e kolegjit,  
Saranda Bogaj Sheremeti**